

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izlaze: Date / Dana: 20 / 06 / 2025		
Nr. Org. 01 Org. jed.	Nr. Prot. 161 Br. Prot.	Nr. Faqeve. 17 Br. Strana.
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
 KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
 MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
 E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga takimi i parë publik i kryetarit, me ç'rast u diskutua edhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Me datën 18 Qershor, është mbajtur takimi i parë publik i Kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ku pjesë e takimit ishin edhe drejtorë të drejtorive komunale, kryetar të fshatrave dhe zonave urbane, mediat dhe shoqëria civile.

Njoftimi për mbajtjen e takimit publik është publikuar me 02.06.2025 në uebfaqe të komunës në vegëzën:

<https://ferizaj.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/06/Njoftim-Takim-Publik-me-qytetare.pdf>

Njoftimi është publikuar edhe në platformën e konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=42835>

Në këtë takim publik të pranishëm ishin: Agim Aliu-Kryetar i Komunës së Ferizajt, Kemajl Emini-Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sabri Murseli-drejtor i Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit, Alberton Sahiti-drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Afrim Llabjani-Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Burim Bajrami-Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Meriton Hajdini-Drejtor i Infrastrukturës, si dhe Balton Dërguti- Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZIAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Me datën 18 qershor duke filluar nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës, është mbajtur takimi i parë publik i Kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu për të raportuar punën gjashtëmujore të këtij vitit si dhe për të diskutuar edhe për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Në këtë takim publik kanë marrë pjesë 50 qytetarë 5 femra dhe 45 meshkuj.

Hapjen zyrtare të këtij takimi e ka bërë Kryetari i Komunës së Ferizaj Agim Aliu, i cili ka thënë se ky takim publik është organizuar duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kryetari Aliu, ka thënë se si Komunë ka vazhduar me përmbushjen e asaj që ka qenë pjesë e angazhimit dhe planifikimit financiar.

Njoftim mbi punën, të arriturat, sfidat dhe projektet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 si dhe diskutimi mbi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Të arriturat në këtë gjashtëmujor (Janar-Qershor 2025):

Në planin e financave:

- Në vitin 2025, mbajtëm në fuqi vendimin përmes së cilit zbritet për 33% tatimi në pronë për vitin 2025, një vendim ky që sjellë barazi dhe drejtësi si për qytetarët ashtu edhe për bizneset;
- Ferizaj u vlerësua Komunë Kampione nga Instituti GAP, me shkallën 100% të shpenzimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, e dhënë kjo që flet për përkushtimin tonë



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

që resurset buxhetore komunale t'i orientojmë në qindpërqindshin e tyre në të mira publike, vepra madhore në dobi të qytetarëve.

- Në këtë periudhë 6 mujore të vitit 2025, morëm vlerësimin më të lartë për transparencën komunale ku Ferizaj u shpall Kampion i Kosovës për Transparencë Komunale, vlerësim ky në kuadër të Transparimetrit Komunal 2024, instrument i zhvilluar nga Instituti Demokratik i Kosovës, përmes së cilës matet e vlerësohet niveli i transparencës komunale për Komunitet e Kosovës.

Në planin e infrastrukturës:

- Pak ditë na ndajnë nga përfundimi i megaprojektit të transformimit urban, nënkalimit të ri tek Stacioni i Policisë në Ferizaj, një vepër e jashtëzakonshme infrastrukturore, që i jep Ferizajt përmasa të reja zhvillimi urban, infrastrukturor e rrjedhimisht edhe zhvillimi ekonomik;
- Po zhvillojmë punimet në modernizimin e infrastrukturës rrugore në gjithë kuadrin në afërsi të nënkalimit të ri tek Stacioni i Policisë, përmes rikonstruktimit e kthimit në rrugë model të rrugës "Brigada 161", rikonstruktimit rrënjësor të rrugës "Bedri Asllani", rikonstruktimit të pjesshëm të rrugës "Driton Islami" dhe lidhjes së saj me rrugën "Cen Dugolli" ku tashmë kemi shndërruar gjithë atë zonë në afërsi të Stacionit të ri të Autobusëve, me rrethrotullimin e ri që rrit sigurinë e qarkullimit si dhe me ishujt e gjelbër të gjithë infrastrukturën përcjellëse që kemi krijuar në këtë arterie rrugore;



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Filluam punimet për rikonstruktimin tërësor të rrugës Ferizaj-Pleshinë, bashkëfinancim me Ministrinë;
- Po vijojmë punimet në rikonstruktimin e rrugës "Tahir Sinani" – rrugë kjo me rëndësi të jashtëzakonshme të lidhjes së qendrës së qytetit me zona tjera të qytetit;
- Përfunduam në tërësi, rrugën Pleshinë – Kashtanjevë, një arterie rrugore kjo prej 11.5 kilometrave, që çliron potencialin turistik të Bjeshkëve të Pleshinës dhe gjithë zonës përskaaj, një mundësi e shtuar për turizmin malor në Ferizaj;
- Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve të qytetit, rregulluam rrugën "Nora Kelmendi" në qytet, arterie kjo me rëndësi për komunikimin rrugor mes zonave të ndryshme të qytetit;
- U asfaltuan afro 2 kilometër rrugë në fshatin Gaçkë, investim ky që lehtëson qarkullimin e banorëve të këtij fshati dhe zonave përreth duke lidhur Gaçkën me fshatin Gurëz dhe qasjen e tyre në autostradë;
- Asfaltuam dhjetëra rrugë në fshatrat e Ferizajt, me qëllim zhvillimin e tyre dhe lehtësimin e qarkullimit për banorët, si në fshatrat Komogllavë, Pleshinë, Neredime, Kosinë, Saraishtë, Dardani, Zllatar, Prelez të Jerlive, Zaskok e të tjera.

Në fushën e mjedisit:



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Për përmbushjen e premtimeve në fushën e mjedisit, Ferizaj u shpall Kampion i Kosovës në Fletënotimin Mjedisor të Komunave, vlerësim ky nga Instituti Demokratik i Kosovës;
- Me hapa të shpejt po përparojmë drejt përfundimit të punëve në rregullimin e Parkut në Kodrën e Sherretëve – një projekt unik ky në gjithë vendin, me ballkonin panoramik e rivitalizimin e gjithë zonës në një park të ri të qytetit;
- Po kështu, po vijojmë punët edhe në zgjerimin e Parkut të Lirisë si dhe rregullimit të amfiteatrit në këtë park, pasurisë sonë të jashtëzakonshme natyrore, e cila përmes këtij investimi shumëfishon hapësirën e saj në shërbim të qytetarëve;
- Sipas konceptit të miniparqeve, Ferizajt iu shtua edhe një park i ri e kënd lojërash për fëmijë, në rrugën "Sali Çeku" në qytet;
- Ferizaj është përfitues i investimit prej afro 400 mijë eurove për rregullimin e parkut në fshatin Varosh, projekt ky në kuadër të investimeve tona për infrastrukturën turistike;
- Në shënim të Ditës së Pranverës dhe Ditës së Tokës, anekënd Ferizajt, mbollëm lule, drunj dekorativ, zhvilluam aktivitete pastrimi të hapësirave publike, duke shtuar e mirëmbajtur vazhdueshëm hapësirat e gjelbërta për qytetarët.

Në fushën e shërbimeve publike:



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Përruam një nga veprat e reja identitare të Ferizajt, Stacionin e Ri të Autobusëve, në një hapësirë jo vetëm moderne, por edhe me funksionalitet të plotë, me lidhje urbane e ndërrbane pa pengesa në trafikun ditor të qytetit;
- Në këtë kuadër, po vijojmë punën për shndërrimin e Stacionit të Vjetër të Autobusëve në park të ri të qytetit;
- Si dhe gjithashtu, për herë të parë Ferizajn e bërmë me transport publik;

-Një nga investimet që përruam në fillim të këtij viti e ku hisedare e këtij investimi është edhe Komuna e Ferizajt, është Nënstacioni i Ri i Energjisë Elektrike, projekt ky i nisur që më 2018 si rrjedhojë e kërkesës dhe bashkëfinancimit nga Komuna e Ferizajt, projekt ky që i jep zgjidhje përrfundimtare furnizimit stabil me energji elektrike për Ferizajn e më gjerë, duke ndjekur kështu edhe shkallën e lartë të zhvillimit ekonomik të Ferizajt dhe nevojës për stabilitet energjetik.

- Fuqizua ndërmarrrjet publike përrmes investimeve të drejtpërrdrejta në blerjen e pajisjeve e mjeteve të punës si për NPL Ambientin, për mirëmbajtjen e hapësirave publike;
- Vazhdua projektin për vendosjen e hidrantëve përrgjatë zonës urbane dhe në fshatrat e Ferizajt, me qëllim të reagimit të shpejt, në raste të fatkeqësive nga zjarri.

Në planin arsimor:



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Për të satin vit me radhë, kemi marr vendimin për ndarjen e bursave për të gjithë studentët ferizajas që aplikuan në konkursin vjetor të bursave për studentë;
- Përruam objektin e ri për dy shkolla të mesme të Ferizajt, për Gjimnazin e Shkencave Shoqërore – Gjuhësore "Dr. Shaban Hashani" si dhe Shkollën e Mesme të Mjekësisë "Elena Gjika", të cilat tashmë kanë hapësira prej afro 5000m², me 36 dhoma mësimi, 2 kabinete shkencore, kabinet të teknologjisë së informacionit si dhe Sallën e Sportit në ndërtim, që i bënë këto dy shkolla, me infrastrukturë moderne;
- Përruam objektin e ri të Shkollës në Talinoc të Muhaxherëve dhe presim të kompletohet së shpejti me inventarin nga MASHT-I, që të funksionalizohet në tërësi ky objekt shkollor;
- Funksionalizuar kopshtin për fëmijë në fshatin Greme;
- Po vijojnë me intensitet të shtuar punimet për ndërtimin e shkollës në rrugën "Sali Çeku" në qytet, si dhe për ndërtimin e shkollave në fshatrat Neredime e Tërrn;
- Investuam edhe në rregullimin e oborreve shkollore duke i kthyer ato në hapësira të reja të gjelbërta për nxënësit dhe komunitetin në përgjithësi si në shkollat: "Vezir Jashari", në shkollën "Arsim Rexhepi" në Sazli, në shkollën "Abetarja" në Softaj, në shkollën e fshatit në Papaz, në shkollën e fshatit në Sojevë, fusha e sportit në Mirash të tjera;
- Vazhduam programin e mbështetjes për mësimdhënësit ferizajas, përmes certifikimit të tyre dhe zhvillimit të trajnimeve profesionale në bashkëpunim me institucione qeveritare e joqeveritare.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Në lëminë e sportit:

Në këto 6 muaj të vitit 2025, u shënuan rezultate të jashtëzakonshme, historike për sportin ferizajas:

- Klubi ikonik i hendbollit ferizajas "Kastrioti" u shpall Kampion i Kupës së Kosovës;
- Klubi i Volejbollit "Ferizaj" - Femrat u shpall Fitues i Kupës së Kosovës në volejboll;
- Klubi i Volejbollit "Ferizaj" (Meshkujt) u shpall Kampion i Kosovës në Volejboll në kategorinë e meshkujve;
- Klubi i Volejbollit "Ferizaj" u shpall Fitues i Kupës së Kosovës;
- Klubi i Volejbollit "Fer Volley" u shpall Kampion i Kosovës në Volejboll;
- Klubi ferizajas i futbollit "Tefik Çanga" hyri në Ligën e Parë të Futbollit të Kosovës;
- Vajzat e Klubit të Volejbollit "Kastrioti" u shpallën kampione të trefishta;
- Karakteristet ferizajase Behije Mustafa dhe Lijana Iseni nga Klubi i Karatesë "Sharri" u shpallën Nënkampione të Evropës në Karate.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Në fushën e aktiviteteve kulturore e rinore, u organizuan ngjarje të shumta si dhe mbështetëm financiarisht dhjetëra organizime kulturore, rinore e sportive përmes Thirrjes Publike të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale:

- Po shkojnë drejt përfundimit punimet në objektin e ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Vijuam punimet në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës së Mjekësisë Familjare në rrugën "Remzi Hoxha";
- Me intensitet të lartë, po vijojnë punimet në ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Koshare, për t'i sjellë më afër banorëve shërbimet shëndetësore;
- Në bashkëpunim me AQH, aktivizuar shërbimin e diagnostikës – funksionalizimin e laboratorëve në qendrat e mjekësisë familjare në Pleshinë dhe Neredime;
- Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, hapëm Këshillimoren për Edukim dhe Promovim Shëndetësor për sëmundjet kronike jongjitime, të furnizuar më parë me pajisje e material pune si rrjedhojë e bashkëpunimit me AQH-në;
- Bëmë digjitalizimin e administratës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Përfituam donacion tri vetura në kuadër të shërbimit të kujdesit paliativ;



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Mbështetëm veprimtarinë e organizatave joqeveritare në fushën e kujdesit e shërbimeve sociale;
- Mbështetëm qindra familje në nevojë, me pako ushqimore e higjienike;
- Mbështetëm hapjen e qendrës unike në vend për të moshuarat, Qendrës "Zonjat Pensioniste".

Në fushën e zhvillimit ekonomik e turizmit:

- Përruam një nga projektet më të veçanta në fushën e turizmit, siç është ura tibetiane dhe Via Ferrata në vargmalet e Jezercit;
- Vlerësuam dhjetëra biznese ferizajase me mirënjohje, për angazhimin e tyre gjatë vitit 2024 të cilët ndikuan në rritjen e ekonomisë lokale, duke krijuar vende të reja pune, duke shënuar rritje të eksporteve, zhvillim të prodhimit të qarkullim të qëndrueshëm ekonomik – me burim të të dhënave sipas ATK-së dhe Doganës së Kosovës;
- Hapëm thirrjen publike për mbështetjen e bizneseve të udhëhequra nga grate në kuadër të Fondit për subvencionimin e start-up-eve, mikrondërmarrjeve dhe bizneseve të grave;
- Hapëm thirrjen publike për trajnime falas për gratë dhe vajzat në fushat e rrobaqepësisë, dizajnit, menaxhimit të rrjeteve sociale dhe gjuhës angleze.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Në fushën e bujqësisë

- Po vazhdojmë punët për rregullimin e Hipodromit dhe Qendrës së Panairëve Bujqësore me lokacion në mes të fshatrave Prelez i Muhaxherëve dhe Papaz;
- Një projekt i veçantë që po zhvillojmë përmes Drejtorisë së Bujqësisë është rregullimi i sillosëve për ruajtjen e grurit në fshatin Papaz me kapacitet prej 8,000 tonelata grurë, si masë për mbrojtjen e çmimit të prodhuesit ashtu që krizat e tregut të mos cenojnë çmimin e grurit;
- Po vijojmë punimet në fazën e fundit për rregullimin e Tregut të Kafshëve dhe Strehimore për Qentë Endacak në fshatin Muhoc, projekt ky që krijon kushtet e duhura për tregtimin e kafshëve dhe rrit sigurinë publike në përgjithësi;

Përmes skemave mbështetëse të subvencioneve nga Drejtoria e Bujqësisë mbështetëm qindra bujq e fermerëve në veprimtarinë e tyre.

- 8 fermerë ferizajas u mbështetën me sistem të ujitjes pikë-pikë, foli të zezë dhe rezervuarë të ujit;
- 5 shpezëtarë ferizajas përfituan makina për vulosjen e vezëve që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë ushqimore;
- 55 fermerë kultivues të pemëve i shpallëm fitues dhe i furnizuar me pajisje;



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Përfunduar procesin e aplikimit për subvencione për 1200 fermerë të Komunës së Ferizajt në kuadër të thirrjes publike të Ministrisë së Bujqësisë;
- Kemi përfunduar Thirrjen Publike për furnizim të fermerëve me serra prej 50 m2.
- Kemi përfunduar Thirrjen Publike për furnizim të fermerëve me gypa dhe pompa për ujitje dhe pritjet shpërndarja e tyre.

Sfidat:

1. Obligimet nga Kontrata Kolektive;
2. Pamjaftueshmëria e mbështetjes qeveritare për projektet komunale

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2026-2028

Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitet 2026-2027				
	Viti 2025 buxhetuar	Viti 2026 Plan	Viti 2027 Vlerësuar	Viti 2028 Vlerësuar
Numri i punëtorëve	2459	2471	2471	2471
Paga dhe mëditje	21,140,016.31	23,807,566.53	23,926,604.33	24,046,237.36
Mallra dhe shërbime	10,001,123.37	12,519,945.40	13,323,806.13	13,859,366.75
Shpenzime komunale	719,694.00	1,010,982.07	1,092,158.96	1,121,676.76
Subvencione dhe transfere	2,050,000.00	2,500,000.00	2,815,575.58	3,016,688.12



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Shpenzime kapitale	12,102,172.32	13,230,000.00	14,859,000.00	16,615,000.00
Totali	46,013,006.00	53,068,494.00	56,017,145.00	58,658,969.00

	Viti 2025	Viti 2026	Rritja e buxhetit për vitin 2026 me %
Paga dhe Mëditje	21,140,016.31	23,807,566.53	12.62
Mallra dhe shërbime	10,001,123.37	12,519,945.40	25.19
Shpenzime komunale	719,694.00	1,010,982.07	40.47
Subvencione dhe transfere	2,050,000.00	2,500,000.00	21.95
Shpenzime kapitale	12,102,172.32	13,230,000.00	9.32
Total:	46,013,006.00	53,068,494.00	15.33

Qytetarët e pranishëm vlerësuan lartë punën dhe angazhimin e Kryetarit Aliu dhe shprehën mirënjohje për projektet që janë realizuar.

1. Lorena Haliti-Asambleja e fëmijëve

Si përfaqësuese e e Asamblesë Komunale të Fëmijëve, ju paraqesim kërkesat e mëposhtme, të cilat janë rezultat i diskutimeve dhe konsultimeve me nxënësit e shkollave përkatëse:

Në shkollën "Halit Ibishi"

- Pajisje për edukatë fizike(topa dhe mjete për pingpong)



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Mungesë mikrofonash dhe pajisjesh për aktivitete shkollore
- Nevojë për një tablet digjital
- Dyert e tualeteve janë në gjendje të keqe dhe kërkojnë ndërhyrje urgjente

Në shkollën "Naim Frashëri"

- Mungesë mjetesh për kabinetin e biologjisë
- Nevojë për topa për orët e edukatës fizike
- Tualetet janë në gjendje shumë të keqe
- Mungesë topash dhe perde
- Temperaturat në klasë gjatë verës janë të larta-mungon ventilimi
- Mungesë lekturash, mjetesh për kimi dhe teknologji
- Disa dyer kanë probleme me rezë
- Në lagjen Prelez i Jerlive mungojnë shenjat e komunikacionit dhe koshat përgjatë rrugëve

Në shkollën "Dardania"

- Mungon salla e sportit
- Nevojë për gjeneratorë
- Mungesë topash për volejboll

Në shkollën "Besim Rexhepi"

- Nevojë për roleta për dritare
- Mungesë e rrjeteve të volejbollit
- Pajisje për lëndën e kimisë

Lagja "Rexhep Mala" dhe "Vëllezërit Gërvalla" (Robert Riza)

- Ndërtimi i një parku të gjelbërt për fëmijët dhe familjet
- Vendosija e masave për ngadalësimin e trafikut

Shkolla "Ramadan Rexhepi"

- Mungesë kompjuterësh
- Nevojë për përmirësimin e kushteve sanitare



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Shkolla "Ali Hadri"-Mirash

- Mungesë kompjuterësh dhe tabelash digjitale
- Nevojë për përmirësimin kushteve sanitare

Shkolla "Visar Dodani"

- Tualet janë të pa pastërtia dhe jofunksionale
- Mungesë mjetesh për lëndën e teknologjisë (TIK, kimi, fizikë dhe biologji).

Pyetjeve dhe komenteve të qytetarëve iu përgjigjën drejtorët e drejtorive komunale, ndërsa për shumë çështje konkrete, sqarime shtesë dha edhe vetë Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu.

Betim Syla- Sojeve

- Të bëhet rregullimi i disa rrugëve të reja në fshat dhe të bëhet asfaltimi

Sadri Aliu

- Të bëhet vendosja e drunjtëve dekorativ përkaj rrugës "Driton Islami"
- Rruga "Idriz Isalmi" të bëhet me trotuarë

Guxim Hajrullahu

- Të bëhet vendosja e policëve të vdekur në rrugën "Zenel Hajdini" si dhe të bëhet lirimi i torturave në rrugë
- Të investohet në bibliotekën e qytetit "Sadik Tafarshiku", në klima dhe në tualete

Besim Sedolli

- Asfaltimi i rrugës kryesore të fshatit
- Të bëhet deblokimi i kanalizimit

Rexhep Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet një rreth rrotullimi në lagjen "Spahiaj"

Njazi Behluli- Talinove i Muhaxherëve

- Të hiqet shkolla e vjetër në mënyrë që të bëhet një sallë e edukatës fizike

Ali Maliqi- Rahovicë

- Të bëhet rregullimi i oborrit të shkollës
- Të bëhet rregullimi i rrugicave

Astrit Rexhepi-Muhove

- Të bëhet asfaltimi i disa rrugicave
- Të bëhet rreth rrotullimi në Muhove
- Të intervenohet në objektin e shkollës

Sabedin Mustafa-Pleshinë

- Të bëhet një rrugë alternative për tek "Kodra e Sherretëve"

Fehmi Osmani-Sazli

- Të bëhet rregullimi i trotuareve në fshatin Sazli
- Të bëhet ndriçimi publik
- Të bëhen disa rrugica shtesë të fshatit

Zymer Berisha -Mirosalë

- Të intervenohet në shkollën e vjetër
- Të bëhet kanalizimi në disa lagje
- Të bëhet një fushe sportive



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Pyetjeve të qytetarëve ju janë përgjigjur drejtorët e drejtorive komunale, si Arbër Bytyqi, Mertion Hajdini, Afrim Llabjani.

Ky takim ka përfunduar në orën 12:30.

Procesmbajtëse
Shyhrete Topalli